



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 17 gusht 2026

Z. Imri Ahmeti, kryetar
Komuna e Lipjanit
Rr. "Shqipëria", nr. 28
14 000 Lipjan

LETËR REKOMANDIMI

R. nr. 475/2026

I nderuar z. Ahmeti,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 16 mars 2026, pranoi ankesën e z. Enver Llugiqi (në vijim: ankuesi), të parashtruar kundër Komunës së Lipjanit, lidhur me mosdhënien e përgjigjes në kërkesën e tij nr. 12-320/01-1606, datë 12 janar 2026, që ka të bëjë me dëmin material të shkaktuar në pronën e tij si pasojë e daljes së lumit nga shtrati gjatë reshjeve atmosferike.

Sipas pohimeve të ankuesit dhe dokumentacionit të paraqitur në Institucionin e Avokatit të Popullit, rezulton se, si pasojë e reshjeve, rrjedha e lumit që ndodhet në fshatin Magure doli nga shtrati dhe shkaktoi dëm të konsiderueshëm në pronën e tij, duke afektuar stallën, ushqimin bujqësor dhe disa pajisje bujqësore për përpunimin e ushqimit. Ankuesi theksoi se lidhur me këto vërshime e njoftoi Komunën e Lipjanit, Policinë e Kosovës dhe Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave, si organe kompetente.

Me qëllim të informimit lidhur me veprimet që komuna ndërmori përkitazi me kërkesën e ankuesit, Avokati i Popullit, më 23 prill 2026, iu drejtua me shkresë kryetarit të Komunës së Lipjanit.

Më 8 maj 2026, Institucioni i Avokatit të Popullit pranoi përgjigje nga Komuna e Lipjanit, përmes së cilës u njoftua se, lidhur me reshjet atmosferike që ndodhën në territorin e komunës, kryetari i Komunës, më 12 janar 2026, themeloi Komisionin ad-hoc për evidentimin e dëmeve të shkaktuara nga vërshimet në sektorin e bujqësisë në Komunën e Lipjanit. Përgjigjes i është bashkëngjitur edhe Procesverbali i komisionit për inspektimin në terren, i datës 26 janar 2026, lidhur me rastin e ankuesit, i cili konstatoi situatën në terren pa dëme.

Me qëllim të sigurimit të informatave shtesë lidhur me procedurat e zhvilluara, përfaqësueset e Avokatit të Popullit, më 15 maj 2026, zhvilluan një takim me kryesuesin dhe një anëtar të Komisionit ad-hoc të lartpërmendur. Gjatë këtij takimi, ato u njoftuan se ankuesit nuk iu dorëzua ndonjë përgjigje me shkrim, përmes së cilës do të njoftohej për refuzimin e kërkesës.

së tij për kompensimin e dëmeve. Po ashtu, u theksua se mosdhënia e përgjigjeve në raste të tilla përbën praktikë të ndjekur nga Komuna e Lipjanit. Sipas përfaqësuesve të Komisionit, pas miratimit nga Kuvendi Komunal, njoftohen vetëm palët që përfitojnë kompensim për dëmet e shkaktuara nga reshjet atmosferike, ndërsa lista e përfituesve i përcillet Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave (AME).

Nisur nga veprimet e ndërmarra nga IAP-ja, në raport me Komunën e Lipjanit dhe në drejtim të trajtimit të ankesës së parashtruesit të ankesës, Avokati i Popullit thekson se neni 135, paragrafi 3, i Kushtetutës së Kosovës përcakton: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*

Duke iu referuar Kushtetutës, po ashtu duhet pasur parasysh nenin 53, që specifikon: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”*

Bazuar në nenin 18.1.2 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka përgjegjësi: *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur institucionet e Republikës së Kosovës i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e institucioneve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.”*

Nga analiza e fakteve dhe provave të siguruara gjatë shqyrtimit të rastit, Avokati i Popullit konstaton se Komuna e Lipjanit, përkundër obligimeve ligjore që i takojnë si organ publik në zhvillimin e procedurës administrative, nuk e ka përmbushur detyrimin për ta njoftuar zyrtarisht palën lidhur me ecurinë dhe rezultatin e procedurës administrative. Në veçanti, mosnjoftimi i ankuesit për konstatimin e Komisionit se në pronën e tij nuk u evidentuan dëme nga reshjet atmosferike cenon të drejtën e ankuesit për shfrytëzim të së drejtës së tij për përdorim të mjeteve juridike.

Avokati i Popullit vëren se neni 11 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton qartë *“Parimin e informimit dhe ndihmës aktive”*, i cili shprehimisht përcakton obligimin e organit publik për të njoftuar palën në procedurë, si dhe procedurat që duhen ndjekur: *“Organi publik, në veçanti, informon palën për të drejtat dhe detyrimet e saj në procedurën administrative, si dhe për pasojat juridike të veprimeve a mosveprimeve të saj gjatë kësaj procedure.”*

Sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj), çështjet që lidhen me mosinformimin e palëve dhe mosdhënien e përgjigjeve nga organet administrative për veprimet e ndërmarra brenda një afati të arsyeshëm kohor trajtohen sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) (E drejta për një proces të rregullt ligjor). Paragrafi 1 i nenit 6 saktëson obligimin e organeve për ndërmarrjen e veprimeve pa vonesa: *“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm...”*¹. Në disa raste që kanë të bëjnë me zhvillimin e procedurave dhe marrjen e vendimeve apo provave nga autoritetet ose gjykatat, pa dijeninë

¹ Rasti Morscher vs. Austria.

e palëve, dhe ndikimi në të drejtën e shfrytëzimit të mjeteve juridike, GjEDNj-ja i ka trajtuar sipas nenit 13 (E drejta për një mjet efektiv ankimi) të GjEDNj-së².

Andaj, bazuar në faktet dhe analizën e rastit, Avokati i Popullit konstaton se, në rastin e ankuesit, Komuna e Lipjanit, në cilësinë e organit administrativ, nuk i përmbushi detyrimet kushtetuese dhe ligjore për ta njoftuar palën në procedurë lidhur me vendimin e saj. Për më tepër, Avokati i Popullit thekson se vendimi nuk i është komunikuar ankuesit në përputhje me formën e një akti administrativ sipas formës së paraparë në Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke pamundësuar që ai të informohej me kohë dhe ta vlerësonte mundësinë e përdorimit të mjeteve juridike.

Me qëllim të përmirësimit të respektimit të së drejtës për një proces të rregullt, si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, në mënyrë që qytetarët ta shfrytëzojnë këtë të drejtë si mjet të fuqishëm për realizimin e të drejtave edhe në instanca më të larta, si dhe me qëllim të përmirësimit të punës së organeve shtetërore dhe rritjen e transparencës dhe llogaridhënies, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i


REKOMANDON

Komunës së Lipjanit:

- T'i përgjigjet ankuesit në kërkesën e tij, në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (*"Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj."*) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (*"Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë."*), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t'i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naïm Qelaj

Avokat i Popullit

² Rasti Kudla vs. Polonia.